

DEKRET
Nr. 45, datë 7.2.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 1/2024 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Republikës së Francës, përfaqësuar nga rajoni *Provence Alpes-Côte D’Azur*, dhe Komisionit Evropian për programin ‘(Interreg VI-B) Euro Mesdhe (EURO MED) 2021–2027”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj